

AKT – THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR " A.G Recycling" SHPK

Sot ne daten 03 .02. 2023 , ne te nenshkruarit :

1.Adnan Quku , i datelindjes 06.09.1977 , lindur ne Durrës,ALB, me banim ne Durres, i pajisur me leternjoftim nr.036737579 dhe nr.personal H70906134P,

2.Xhigert Zeqa , i datelindjes 23.06.2004 , lindur ne Durrës,ALB, me banim ne Durres, i pajisur me leternjoftim nr.036938560 dhe nr.personal K40623074V,

Ne baze te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", kemi vendosur te themelojme shoqerine me pergjegjesi te kufizuar " **A.G Recycling" SHPK.**

NENI 1

EMERTIMI I SHOQERISE

Shoqeria do te quhet " **A.G Recycling" SHPK** dhe eshte person juridik shqiptar. Veprimtaria e saj rregullohet sipas neneve te ketij statuti dhe Ligjit 9901 date 14.04.2008, si edhe Ligjit per QKR-se .

NENI 2

SELIA E SHOQERISE

Shoqeria do te kete seline e saj ne Durres, Bisht Kamez,Objekt me nr.pasurie 59/14,Zone Kadastrale 1198.

Shoqeria mund te krijojte filiale, zyra perfaqesimi, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.



NENI 3

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Shoqeria do te kete si objekt te veprimtarise se saj:

Riciklim i paisjeve elektrike dhe elektronike.

Grumbullimin e tregtimin e marmitave katalitike, etj. Grumbullim dhe demontim të marmitave katalitike dhe tregtim të elementëve të tyre. Grumbullim dhe tregtim për qëllim riciklimi të materialeve ferror dhe jo ferror. Grumbullimin, riciklimin. Import-eksport i skrapeve mikse, të skedave elektronike të ndryshme dhe përpunimi i tyre, grumbullim, riciklim, përpunim i plasticës. Importeksport të pajisjeve elektronike.



elektroshtëpiake të reja dhe të përdorura. Përpunim i metaleve të çmuara: ar (AU), argjend (AG), platin (PT), palladium (PD), rodium (RH), etj

NENI 4

KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali i shoqerise "A.G Recycling" SHPK eshte 100.000 Leke .

Ky kapital eshte i ndare ne 2 kuota.

Kontributi i ortakeve eshte i ndare si vijon

1.Adnan Quku, zoteron 50% te kapitalit .

2.Xhigert Zeqa, zoteron 50% te kapitalit.

NENI 5

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar.

NENI 6

ORGANET E SHOQERISE

-Asambleja e pergjithshme.

-Administratoret.

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

Asambleja e pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshitet e meposhtme:

-Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.

-Ndryshimin e statutit.

-Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve.

-Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe te ekspereve kontabel te autorizuar.

-Percaktimin e shperblimeve per administratorin,likuiduesin dhe ekspertin kontabel.

-Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret,perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.

-Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit.



-Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.

-Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.

-Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

-Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese.

-Çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.



ADMINISTRATORET

Administrator i shoqerise do te jete zoti Klejdi Lelja, i datelindjes 16.12.1987, lindur ne Durres, ALB, me banim ne Durres, i pajisur me leternjoftim nr.035416946 dhe nr.personal I71216045K, i cili emerohet per nje periudhe 5-vjeçare, me te drejte riparteritje te ketij afati. Administratori mund te shkarkohet ne çdo moment nga asambleja, me shumicë të thjeshte te votave, me kusht që në mbledhje të marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave. Statuti apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizojne kete te drejte.

NENI 7

Shpërndarja e fitimit vjetor të shoqërisë

Pjesa e fitimit që i takon secilit ortak nga vlera e fitimit vjetor të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë, vendoset të shpërndahet nga asambleja e përgjithshme.

Asambleja e Përgjithshme ka kompetencë t'u shpërndajë ortakëve pjesën e fitimit në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar, që kuotat e secilit ortak përfaqësojnë.

Po ashtu, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë që një pjesë e fitimit vjetor të mos u shpërndahet ortakëve, por këto shuma të përdoren për zmadhimin e kapitalit fillestar apo për qëllime të tjera, të cilat ajo i konsideron të dobishme për shoqërinë.

NENI 8

Prishja e shoqerise.

Prishja e shoqerise

Shoqeria prishet :

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj,
- b) me vendim te asamblese se pergjithshme,
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit,
- ç) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723 date 3.5.2007 per "QKR",
- d) me vendim te gjykates,
- dh) per arsye te tjera ,te parashikuara ne statut.

NENI 9

Likuidimi i shoqerise.

Në rast të likuidimit të shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme emëron një likuidator, i cili administron shoqërinë deri në mbylljen e procesit të likuidimit.

Xhigert Zeqa

Me vendimin e posaçëm të Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicë të kualifikuar, pasi janë shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditorëve të shoqërisë, likuidatori shpërndan pjesën e mbetur të pasurisë së shoqërisë ndërmjet ortakëve. Kjo shpërndarje e fundit bëhet në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar, që kuotat e secilit ortak përfaqësojnë. Likuiduesit duhet të ftojnë kreditorët për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj. Shoqëria e publikon dy herë këtë njoftim, me një interval prej 30 ditësh, në faqen e saj të internetit, si dhe në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Biznesit. Në njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet të depozitohen brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të fundit.


NENI 10

Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë. Veprimtaria e likuiduesit nuk mund të kundërshtohet pas çregjistrimit të shoqërisë nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE " A.G Recycling" SHPK

1. Adnan Quku



2. Xhigert Zeqa

